

Sylejman (Maliq) Hoxha

(19.11.1938, shqiptar nga Samadraxha/
Samodraža, komuna e Suharekës/Suva Reka,
bujk, dy fëmijë)

Forcat serbe e bombarduan **Samadraxhën/Samodraža** më 25.08.1998. Pastaj, filluan tu vënin zjarrin shtëpive të fshatit. Sylejmani e ka strehuar familjen te vjehri në fshatin Zojz/Zojic [komuna e Prizrenit/Prizren]. Të nesërmen, më **26.08.1998**, ai u kthye në Samadraxhë/Samodraža. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Pas dhjetë ditësh, djali i Sylejmanit, Florimi, ka shkuar në fshat për të mësuar për fatin e të atit. E ka gjetur trupin e tij të pajetë në oborrin e shtëpisë së shkruar. Po atë ditë, disa komshinj, të cilët nuk e kishin braktisur fshatin, e kanë varrosur Sylejmanin në varrezat e fshatit, ndërkaq Florimi u kthye menjëherë në Zojz/Zojic, për shkak të drojës nga kthimi i forcave serbe. Pas përfundimit të luftës, gati dy vjet nga vrasja e Sylejmanit, mbetjet e tij mortore u zhvarrosën dhe u dërguan në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac. Një muaj më vonë, familjarët i kanë marrë mbetjet mortore të Sylejmanit dhe i kanë varrosur në varrezat e Samadraxhës/Samodraža.

Burimet: deklarata A.H, FDH-10971; deklarata S.H, FDH-3685; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; J. Osmani, *Krimet...*, 347.

Agim (Bilall) Manxhuka

(1.12.1963, shqiptar nga Samadraxha/
Samodraža, komuna e Suharekës/Suva Reka,
punëtor, tre fëmijë)

Agimi me familje e kanë braktisur Samadraxhën/Samodraža më 25.08.1998, një ditë para sulmit të forcave serbe. U strehuan te një mik në Mamush/Mamuša [Prizren]. Ditën e nesërme, më **26.08.1998**, Agimi shkoi në fshatin fqinj të **Studençanit/Studençane**, për të aderuar në radhët e shtabit të atjeshëm të UÇK-së. Në atë fshat jetonte edhe halla e tij, Shyqërije. Një javë më vonë, babai i Agimit, Bilalli, me një mik u nisën për në Studençan/Studençane të shihnin çfarë kishte ndodhur me Agimin. Në oborrin e Shyqërijes, e kanë gjetur trupin e karbonizuar të një burri. Për

shkak të të reshurave intensive në ato ditë, kufoma e burrit të panjohur ishte mjaft e dekompozuar. Bilalli besonte se nuk bëhej fjalë për Agimin. E lanë trupin aty ku ishte. Pas dy ditësh, bashkëshortja e Agimit me vjehrin kanë shkuar në Studençan/Studençane, por trupi i burrit të panjohur në ndërkohë ishte varrosur në oborrin e Shyqërijes. Daja i Agimit, Hajrush Krasniqi, e kishte identifikuar Agimit në bazë të rrobave të trupit dhe e ka varrosur. Pesë muaj më vonë, më 26.08.1998, familjarët i kanë transferuar mbetjet mortore të Agimit në varrezat në Samadraxhë/Samodraža. Pas përfundimit të luftës, në fillim të muajit gusht të vitit 2000, mbetjet e tij mortore u zhvarrosën. Pas obduksionit të kryer në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac, familjarët sërish e kanë varrosur Agimin në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata N.M, FDH-10991; deklarata S.H, FDH-3685; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838.

Bajram (Zeqir) Bungu

(13.01.1924, shqiptar nga Grejqefci/Grejçevce,
komuna e Suharekës/Suva Reka, i papunë, i
martuar)

Në datën **26.08.1998**, familja e madhe e Bajramit u strehua në pyllin e quajtur *Gjutet*, përmbi fshatin **Grejqefc/Grejçevce**. Bajrami ka mbetur në shtëpi. Një ditë më vonë, familjarët mësuan nga ushtarët e UÇK-së se Bajramin e kishin vrarë dhe se trupi i tij gjendej në *Lagjen Reshan/Raşan*. Ka pësuar nga eksplozimi i granatës. Po atë ditë, burrat e familjes Bungu me disa ushtarë të UÇK-së e kanë varrosur Bajramin në varrezat e *Lagjes Reshan/Raşan*.

Burimet: deklarata M.B, FDH-11402; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 114, FDH-23857; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-24707.

Isuf (Ahmet) Qatani

(28.12.1960, shqiptar nga fshati Duhël/Dulje,
komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, pesë
fëmijë)